

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Taksë e fshehtë" mbi naftën për rezervën e sigurisë, do të rritet çmimi, e pranon dhe qeveria
ADRESA	https://piranjat.al/aktualitet/takse-e-fshehte-mbi-naften-per-rezerven-e-sigurise-do-te-rritet-cmimi-i104758
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 05:32:19 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 05:16:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	cac4da8d89a2ab98f39ebec637876f5ae5a819869fa9e798557e3023bf44a254
TEKSTI	06c454e81fdbe7c398bcaed32b12f9adfebda6e4c0b7bb9942747d099f71045b
PAMJA	169d37689eb5b2e34856b01591ac5a377e665a4aec90439c5b9785c069955

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c7fe7a77ac4597414aa07df705a0ece6debd5b56cbeb55a0eb27efad51408065
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0c0dec12bc237ce7a3b53840342154b6dec8e6e0aa6a337693272add88847ea6
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/c7fe7a77ac4597414aa07df705a0ece6debd5b56cbeb55a0eb27efad51408065

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

SYRI LIVE



Flash:

[të mbyllin muajin, e](#)

[familja në gjendje](#)

■ [rezervuar yjet për ju](#)

[gjerat do ecin mjaft mire mes](#)

■ [masiv me grushte](#)

[rinjve. Siç shihet](#)

■ [të rinj. Zbardhet](#)

[jetën në aksidentin rrugor në rrugën](#)

■ [dhe pse është kaq](#)

[midis Jemenit, në Gadishullin](#)

■ [komisari 1: Lironi](#)

AKTUALITET

“Taksë e fshehtë” mbi naftën për rezervën e sigurisë, do të rritet çmimi, e pranon dhe qeveria

Piranjat Përditësimi i fundit 18 Shtator 2026, 07:16



Qeveria propozoi të krijojë rezervën strategjike të naftës në pronësi të shtetit shqiptar, por një pjesë e koston së saj do të përballohet nga operatorët privatë, të cilët pritet që këtë kosto ta transferojnë në çmimin final të pakicës.

Edhe vetë qeveria ka ranuar në raport e saj se sigurimi i fondeve do të kërkojë, ndër të tjera, vendosjen e tarifës që do të aplikohet mbi sasitë e produkteve energjetike hidrokarbure, çka do të sjellë rritje të ngarkesës financiare në zinxhir dhe do të reflektohet në rezultatin final të çmimit të shitjes te konsumatori.

Rezerva synon të përdoret në raste emergjencash, kur importet mund të ndërpriten dhe vendi ka nevojë të garantojë furnizimin me karburant për shërbime jetike, si ambulancat apo mjetet e ushtrisë.

Projektligji, në nenin 8, përcakton se rezerva do të krijohet përmes depozitimit të naftës nga një Autoriteti shtetëror që do të krijohet dhe në marrëveshje me operatorë privatë të licencuar. Në këtë mënyrë, kompanitë private do të ngarkohen të depozitojnë fizikisht karburant për llogari të shtetit, me qëllim krijimin e rezervës së sigurisë.

Por përveç detyrimit për depozitimin fizik të produktit, operatorët do të ngarkohen edhe me një pagesë të përcaktuar në projektligji si “tarifa e rezervës së sigurisë”. Kjo tarifë do të shkojë në një fond që do të përdoret për mbulimin e shpenzimeve të krijimit të rezervës fizike, mirëmbajtjes, monitorimit dhe kostove të tjera të skemës. Ndërsa pjesa tjetër e shpenzimeve për mirëmbajtjen e rezervës, sipas draftit do të mbulohen edhe përmes kredive, të ardhurat nga buxheti i shtetit, të ardhurat nga shitja e rezervave etj.

Shoqata e Hidrokarbureve ngre shqetësime për mënyrën se si qeveria parashikon ta financojë modelin e ri të propozuar për krijimin e sigurisë së naftës.

Sipas tyre, drafti nuk përcakton asnjë kosto se sa do të kushtojë blerja e karburantit për rezervën, magazinimi dhe rinovimi i stokut, ndërsa mbetet i paqartë edhe trajtimi i humbjeve në rast se çmimi i karburantit bie pasi rezerva është blerë.

Projektligji përcakton një tarifë mbi produktet hidrokarbure të akcizës, për të cilën Shoqata e Hidrokarbureve argumenton së pari, se kjo pagesë nuk mund të konsiderohet si tarifë për një shërbim, pasi nuk bëhet fjalë për një shërbim që shteti i ofron kompanive, por për financimin e një detyrimi publik përmes një tarife të vendosur mbi karburantet.

Kjo pagesë, sipas Shoqatës të Hidrokarbureve do të kthehet në një kosto shtesë për konsumatorin, pasi do të përfshihet në çmimin e karburantit. Për këtë arsye Shoqata e Hidrokarbureve e konsideron “taksë të fshehtë”, antikushetuese pasi niveli i saj nuk do të miratohet nga Parlamenti, por nëpërmjet vendimit të ministrive të linjës.

Ndërkohë në muajin tetor të vitit 2025, Qeveria miratoi projektligjin për krijimin e rezervave të sigurisë së naftës, por një dokument zyrtar që shoqëroi nismën gjatë fazës së konsultimit përcaktonte qartë se tarifa për financimin e skemës do të ndikojë në çmimin final të karburanteve.

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit, i hartuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë gjatë fazës së konsultimit, evidenton një efekt potencial të drejtpërdrejtë në çmimin që paguhet në treg.

Dokumenti analizon disa alternativa dhe përcakton si opcion të preferuar Opcionin 1, hartimin dhe miratimin e një ligji të ri për rezervat e sigurisë.

Në analizën e ndikimeve të politikës, Ministria parashikon se krijimi dhe funksionimi i sistemit do të financohet, ndër të tjera, përmes një tarife mbi sasitë e produkteve hidrokarbure.

“Sigurimi i fondeve do të kërkojë, ndër të tjera, vendosjen e tarifës që do të aplikohet mbi sasitë e produkteve energjetike hidrokarbure”, thuhet në raport. Sipas të njëjtit dokument, kjo do të sjellë rritje të ngarkesës financiare në zinxhir dhe do të reflektohet në rezultatin final të çmimit të shitjes të konsumatori.

Më tej, në pjesën ku analizohen kostot për bizneset, raporti është edhe më i drejtpërdrejtë. Ai parashikon vendosjen e tarifës mbi produktet hidrokarbure që i nënshtrohen akcizës dhe shton se “kjo do të ndikojë në çmimin final të shitjes së nënprodukteve në tregun vendas”.

Edhe përmbledhja ekzekutive e raportit parashikon tarifa financiare për bizneset. Sipas saj, këto kosto vlerësohen si minimale dhe tarifat do të mbledhen pasi produkti të jetë shitur për konsumatorin final.

Raporti nuk jep një përlllogaritje se sa mund të jetë efekti në lekë për litër. Niveli i tarifës nuk përcaktohet në vlerësimin e ndikimit dhe kostot nuk janë kuantifikuar, diçka që nuk e bën ende të mundur të përcaktohet ndikimi real i rritjes së çmimit.

Vetë mekanizmi gjithsesi ishte parashikuar që në fazën e konsultimit: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, së bashku me Ministrinë e Financave, do t’i propozonin Këshillit të Ministrave tarifen për krijimin dhe mbajtjen e rezervës së sigurisë, të aplikuar mbi produktet hidrokarbure që i nënshtrohen akcizës.

Edhe pa këtë taksë, Shqipëria, ndër vendet më të varfra të Europës është e treta më e shtrenjë në vlerë, me naftën që tregtohet aktualisht në gati 2.5 euro, në nivele gati të njëjta me Norvegjinë dhe Danimarkën. E matur sipas guqisë blerëse, nafta është 2.6 herë më e shtrenjë se mesatarja europiane.

Arsyeja kryesore lidhet me barrën e rëndë të taksave, që përbëjnë gati gjysmën e çmimit, nga rreth 30% që e ka rëndesën rajoni, teksa ky i fundit ka zbatuar vazhdimisht dhe lehtësi fiskale. Por, në vend të që ulët taksat, qeveria, në kulmin e krizës, ndërmori një veprim që pritet të rrisë edhe më tej çmimin. / Monitor

Artikuj te sugjeruar

AKTUALITET 17 Shtator22:28

[VIDEO nga momenti i sherrit masiv me grushte, karrige dhe thika në Sarandë](#)

Dalin pamjet nga sherrri i ndodhur në Sarandë, mes të rinjve. Siç shihet nga video, të rinjtë përplasen mes tyre me grushte ...

AKTUALITET 17 Shtator21:55

[Këta janë tre të rinjtë nga Fieri që humbën jetën nga aksidenti tragjik në Athinë](#)

Një aksident tragjik ka ndodhur në orët e para të mëngjesit në lagjen Glifadha të Athinës, ku kanë humbur jetë...

AKTUALITET 17 Shtator21:53

[Reforma territoriale/ Banorët e Divjakës në ditën e 49-të të protestës, thirrje: Divjaka bashki](#)

Protesta në Divjakë ka vijuar për të 49-tën ditë, ndërsa qytetarët kundërshtojnë reformën e propozuar adm...

AKTUALITET 17 Shtator21:43

[Ky është vendi i aksidentit tragjik ku humbën jetën tre të rinj. Zbardhet dinamika e ngjarjes së rëndë dhe “roli” i një vajze](#)

Ky është vendi ku tre të rinj humbën jetën në aksidentin rrugor në rrugën Poseidonos në Greqi, ndër...

AKTUALITET 17 Shtator21:29

[“Lironi rrugën!”, Policia ndalon marshimin e protestuesve drejt Parlamentit](#)

Marshimi i qytetarëve në Tiranë është përballur me një bllokim nga forcat e policisë, teksa protestuesit po lëvizni...

AKTUALITET 17 Shtator21:09

[Tragjedi në Athinë, 3 të rinj shqiptarë humbin jetën në aksident](#)

Një tragjedi e rëndë ka tronditur komunitetin shqiptar në Greqi dhe familjet në Fier. Tre shqiptarë kanë humbur jetën n&...

AKTUALITET 17 Shtator20:18

[‘Rrezikojmë jetën për 64 mijë lekë’, denoncimi i elektrikistit të OSHEE: Veglat i blejmë vetë](#)

“Rrezikojmë jetën për 64 mijë lekë në muaj dhe duhet të jemi gjithmonë gati për çdo problem”, sh...

AKTUALITET 17 Shtator20:12

[Çoi padashje një video në grupin e shoqeve, si u zbulua abuz*mi i vajzës në Tiranë nga djali i hallës dhe tezja](#)

Një ngjarje e tmerrshme është bërë publike ditën e sotme, 17 shtator, ku është mësuar se një 12-vjeçare...

AKTUALITET 17 Shtator19:54

[Me 200 km/orë në Audi RS8 për të dërguar 50 mln euro kokainë. Si u godit banda e rrezikshme shqiptare](#)

Policia spanjolle ka goditur një organizatë kriminale shqiptare të rrezikshme, e cila e kishte qendrën në Katalonja. Gjatë kë...

AKTUALITET 17 Shtator19:52

[“Rrezikojmë jetën për 64 mijë lekë”, denoncimi i elektrikistit të OSHEE: Veglat i blejmë vetë](#)

[Pankartat e protestës së 110-të kundër qeverisë kanë përcjellë mesazhe të drejtpërdrejta ndaj kryeministrit Ed...](#)

Pankartat e protestës së 110-të kundër qeverisë kanë përcjellë mesazhe të drejtpërdrejta ndaj kryeministrit Ed...

ME TE VIZITUARAT

POLITIKE 17 Shtator

[Tensionet te ministria e Brendshme, shoqërohet ...](#)

Vijojnë tensionet para Ministrisë së Brendshme. Një grup protestuesit kanë hedhur letra higjienike në drejtim të policisë&e...

SHOWBIZ 17 Shtator

[Susan Sarandon zbulon pse nuk u martua me Tim R...](#)

Susan Sarandon dhe Tim Robbins kaluan 23 vite së bashku, rritën dy fëmijë dhe për shumë kohë u konsideruan një nga &cc...

AKTUALITET 17 Shtator

[Operacion antidrogë në Korçë, arrestohen 3 të r...](#)

Finalizohet një operacion antidrogë në Korçë, në kuadër të të cilit janë arrestuar tre persona dhe jan&eum...

INVESTIGIME 17 Shtator17:59

[Tensionet te Kuvendi, shoqërohen në polici të paktën 25 protestues](#)

Të paktën 25 persona janë shoqëruar nga policia pas tensioneve të regjistruara gjatë protestës së zhvilluar sot pran&eum...


video




E premte | ? 20:45 | Syri TV



E premte | ? 20:45 | Syri TV



Çdo të premte | ? 20:45 | Syri TV



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.